

THE SYMBOLISM OF CHIMERAE MYTH SIMBOLIKA E MITIT TË HIMERËS

IRENA GJONI

Universiteti I Tiranës, Filiali I Sarandës, Departamenti Letërsi Shqipe, Sarandë, Albania
Gjoniirena@Yahoo.Com

AKTET V, 4: 657-664, 2012

PERMBLEDHJE

Objekti i këtij studimit është miti i Himerës. Synohet të analizohet dhe të shpjegohet simbolika e lidhjeve të mitit të Himerës, funksionit dhe formës së shprehjes së tij, të njohur që te etruskët dhe grekët. Atë e gjejmë edhe te kaonët, si një ndër mitet më të rëndësishme të kësaj zone. Miti i Himerës, i lidhur dhe me atë të Akrokerauneve, në Kaoni merr një rëndësi të veçantë, sepse është i lidhur me toponiminë e njërit prej vendbanimeve më të rëndësishme të Kaonisë, Kimerën (Himerën, Himarën). Analiza mbështetet mbi dëshmitë e shkruara të periudhës antike dhe në gërmimet arkeologjike. Për herë të parë emrin Kimera, si toponim Kaon, e përmend Homeri te "Odisea". Këtë mit më pas e përmendin Hesiodi dhe Virgjili. Përmes metodës induktive, sheshtohen e sheshohen teori të ndryshme për të arritur më pas në një mendim-sintezë, në përfundimin se miti i Himerës kaone është më i qëndrueshëm, se lidhet direkt me ekzistencën e një toponimi shumë të hershëm. Zbërthimi dhe shpjegimi i simbolikës së tij me anë të shqipes janë të rëndësishëm për historinë e artit, në përgjithësi e për mitologjinë shqiptare dhe atë botërore në veçanti

Fjalët kyçe: mit, mitologji, Kaoni, Kimera, histori e artit, analizë, sintezë, toponim..

SUMMARY

The object of this study is the myth of himerës. It is intended to be analyzed and explained the symbolism of myth himerës links and form of his expression, known to the etruscans and greeks. He was also found kaonët, as a most important myths of this region. The myth of himerës, associated with it akrokerauneve in kaoni takes a special importance because toponymy is associated with one of the most important settlements kaonisë, kimerën (himerën), (himara). Analysis based on written evidence of period antiques. For the first time named kimera, as toponym kaon, homer mentions the "odyssey." this myth then cite hesiod and virgil. Through the inductive method, sheshtohen different theories on this myth. To reach further into a thought-synthesis in the conclusion that the myth of himerës kaone is stable, that is directly related to the existence of a very early toponimi be broken down and help explain its symbolism is important for the history of art, in general, and albanian and world mythology in particular.

Key words: myth, mythology, Kaoni, Kimera, art history, analysis, synthesis, toponym.

HYRJE

Mitet në zonën e Bregdetit të Jonit shqiptar, zënë një vend të rëndësishëm në etno-kulturën e kësaj krahine. Një nga më të rëndësishmet e kësaj treve ka qenë ai i Himerës. Është synuar të zbërthehet dhe analizohet duke bërë kërkime mbi lidhjet midis mitit të Himerës dhe formës së shprehjes së tij. Për vetë specifikat gjeografike të

kësaj krahine, për të zbërthyer më mirë simbolikën e tij, është parë i lidhur me atë të Akrokerauneve. Ana rrëfimtare e mitit, natyra e tij si histori e treguar që përbëhet nga tërësia e varianteve të tij, jep një panoramë më të qartë. Kërkimi i invarianceve dhe përcaktimi i një modeli referimi, realizohen vetëm duke filluar nga mbivendosja e një numri shembujsh ose

konkretizimesh të mitit. Ndërsa rrjedha e kërkimit në simbolikën e tij, ecën përmes përafrimeve të njëpasnjëshme. I njohur që te etruskët dhe grekët, miti i Himerës te kaonët merr një rëndësi të veçantë, sepse është i lidhur me toponiminë e njërit prej vendbanimeve më të rëndësishme të Kaonisë, Kimerën (Himerën, Himarën). Zbërthimi i simbolikës së Kimerës si toponimi, në thelbin e tij si origjinë, është i vështirë, por me interes në sqarimin e shtresave më të hershme kulturore të mitit në formën e tij më të lashtë. Për herë të parë emrin Kimera si toponim Kaon dhe kimerë për popullsinë e këtij vendi, e përmend Homeri te *Odisea*: “...nga Perëndimi/ kur rrugët i mbulojnë hijet e natës, arritëm në kufijtë e oqeanit, /ku truall e banesa kanë kimerët./Jeton ky popull krejt mbuluar me mjergull /edhe me re, pëlhurë që kurrë s’e çan/të thuash një rreze dielli, as kur ky /i ngjitet qiellit as kur zbret nën dhe./Mbi ata të mjerë kish rën nata e amshuar...” (Homeri, 2006, Kënga XI. v. 15, 188).

Po që kur i ka fillat e banimit, kjo Krahinë që sot quhet Bregdeti i Jonit shqiptar? Mendohet qysh në shekullin XII p. l. K.. Këtë e dëshmojnë qartë gërmimet arkeologjike, varret, qeramika e kalatë e shek. XII p. l. K. e në vijim. Ka qenë një trevë e përfshirë brenda Kaonisë e banuar nga kaonët që përmenden për herë të parë prej Hekateut, shek. VI - V p.l.K.. Më pas prej Skylaksit, Tuqididit, Straboni etj.. Me Kaoninë lidhet një pjesë e rëndësishme e mitologjisë së lashtë epiro – iliriote. Perënditë dhe heronjtë e *Iliadës* dhe të *Odisesë* së Homerit, “i bien kryq e tërthor Kaonisë” (Pukëvili, 1999: 71). Pra është normale që në këtë truall mitik mos të mungonte edhe miti i Himerës.

1. Miti i akrokerauneve

Një ndër mitet më të rëndësishme që besohet e nderohet tek banorët e hershëm të Bregdetit të Jonit, ka qenë **rrufeja** dhe **shkreptima** e saj. Thuhet se në malet Akrokeraune (nga greqishtja ky emër do të thotë malet e Vetëtimave), ato kishin vendbanimin e tyre. Sipas Çabejt, keraunos kishte kuptimin perëndi e bubullimës dhe e vetëtimës (Çabej V, 1976: 201).

Një shpjegim i ngjashëm jepet edhe nga Pukëvili: “Akrokeraunet janë emërtuar kështu, që në lashtësi, nga termi grek ‘keraunos’ që do të thotë ‘bubullimë’ për arsye të lartësisë dhe veçanërisht për shkak të ekspozimit të tyre ndaj detit të ndriçuar shpesh me dritën e vetëtimave” (Pukëvili, 1998: 7).

Kur për perënditë e ndryshme u zbatua sistemi i antropomorfizmit, perëndia e rrufesë mori emrin e Zeusit ose të Diausit. Një mbishkrim i zbuluar në Mantini (Greqi) dhe botuar prej Foucard për nder të Diausit rrufelëshues, dëshmon se fillimisht Diausi a Zeusi identifikohet me rrufenë (Desharme, 1959: 47). Krahina e pellazgëve himariotë, të cilën Homeri e përmend si të mbuluar prej resh të vazhdueshme, “ku truall e banesa kanë kimerët./Jeton ky popull krejt mbuluar me mjergull/ edhe me re” (Homeri, 2006, Kënga XI. v. 15, f. 188.) dhe që ishin rezultat i vullkaneve të shumta në malet e saj të larta. Ky besohet si vend i preferuar nga Hyjnitë Rrufelëshuese e më vonë nga Zeusi ose Diausi. Stefan Bizantini shkruan: “Në perënditë që nderonte posaçërisht nënfisi i Keraunëve në Bregdetin e Jonit, si pjesë e Kaonisë, përmendim Zeusin kaon “Zeus Kaonios” (Hamond, *Epirus*, 679).

Dhimitri Pilika thekson se si arma më shkatërrimtare e Zotit pellazg, rrufeja ka mishëruar kurdoherë një simbol nga më luftarakët e Dodonës. Rrufeja gjendet e përfaqësuar nga më se 15 emisione në shtetin e Epirit që qarkullonin midis qindramijëra kaonëve, molosëve, thesprotëve disa here çdo ditë (Pilika, 2005: 194). Dihet se shufrat e rrufesë së zotit rrënonin gjithçka, me përjashtim të mburojës së farkëtuar prej Hefesit, sikur na e sqaron edhe Homeri duke përshkruar dyluftimin midis hyjnive dodonase, Aresit dhe Athenasë: “...si foli ashtu, qëllloi shqytin e tmerrshëm,/ Stolitur anash plot me thekë floriri,/ Që as rrufeja e Zeusit nuk e mposhte”.

Rrufeja dëshmohej si një nga dhuratat më të shpeshta që i kushtoheshin Zeusit. Në rrënojat e qytetit antik Meandria (Borsh) në një varr monumental të shek.III p. l. K. mes 34 objekteve

si: kandelaber, shtizë, strigël është gjetur edhe një simbol rrufeje prej hekuri.

Ndërsa Gerold Dommernuth-Gudrich lidhjen e Zeusit me rrufenë e shpjegon kështu: *“Zeusi i çliron ciklopët nga Bota e Hijeve, kur bashkë me olimpikët vendos të shtjerë në dorë pushtetin e Kronit dhe të Titanëve. Për mirënjohje ata i farkëtojnë rrufenë dhe shkrepëtimat. Mjeku i madh, Asklepi, bir i Apolonit, do të jetë një nga viktimat e para që Zeusi do ta godasë me rrufenë e tij. Apoloni, i zhytur në trishtim, nuk ua fal që ata e pajisën Zeusin me rrufe dhe i dënon me vdekje tre ciklopët”* (Dommernuth-Gudrich, 2006: 295).

Po ashtu edhe poeti latin, Ovidi, (43 p.l.K. – 18 p. l. K.) te *Metamorfozat I* (bot. v. 1992), shkruan: *“Kur gjigandët duan të shkatërrojnë qiejt dhe t’i ngrenë malet deri tek yjet, Zeusi i dërrmon ata me një goditje rrufeje”*. Pra, si vërejmë nga analiza e të gjitha rasteve të mësipërme, ka një lidhje shumë të ngushtë midis rrufesë e shkrepëtimës së saj dhe toponimit të maleve Akrokeraune (maleve të Vetëtimave).

2. Origjina e krijimit të mitit të Himerës

Vetë legjenda e maleve Akrokeraune të Himarës, na çon në një përbindësh mitologjik të quajtur Himera.

Himera e ka një histori krijimi. Grekët e lashtë e vendosin këtë kafshë në Licia (gjendur në Azinë e Vogël). Kafshë, të cilët kanë ngajshmëri me të, janë gjetur në monumentet e Hititëve. Koka e gjarprit përmendet si nga Hesiodi dhe Homeri dhe misteri më i madh ngelet koka e luanit. Në një vazo protokorinthiane jepet një luan mbi kurrizin e të cilit ka *“mbirë”* një kokë njeri- shenjë kjo e fillimit të mpleksjes së tipareve të kafshëve të ndryshme, për të krijuar qenie mbinatyrale. E njëjta gjë është gjetur edhe në disa zbukurime të hershme etruske. Sfinksit i famshëm mund të klasifikohet si i tillë, ku koka e njeriut dhe ajo e luanit këmbëjnë vendet për rëndësi, duke vënë atë të njeriut në vendin më të rëndësishëm. Arkeologët kanë gjetur një tip Himere ku luani ka krahë, krahë që përfundojnë në fund me kokën e një dhie (Jorgji, 2011: 3).

Ishte bijë e Tyfonos dhe e Ehidnas që u vra nga Belerofonti në Likia. (Vetë Tyfono është ndërmjet të tjerave edhe prindi i Sfinksit. Është bir i Gjeas dhe Tartarit, një qenie me 100 duar, që nisi luftën kundër perëndive dhe për këtë ata e dërguan në Tartar nën Malin Etna, ku është edhe vullkani i famshëm. Në Egjipt, Tifoni quhet Set dhe është vrasësi i vëllait (apo babait) të tij Osiris. Shpesh ai identifikohet me Taifunin, një nga erërat e fuqishme, që kishte si baba, Eolin, apo perëndinë e erërave).

Si burime të mitit në dokumentet e shkruara, janë Homeri dhe Hesiodi dy autorët e parë dhe të rëndësishëm që e kanë përmendur dhe përshkruar mitin e Himerës. Homeri (shek 9-8 p. e. s.) e përmend fillimisht tek *Iliada* kënga 6, v. 214 kur e përshkruan: *“Ajo vjen nga raca hyjnore, jo njerëzor. Nga koka është luan dhe në mes është dhi me bisht gjarpri e nxjerr nga goja me forcë në mënyrë të tmerrshme zjarr.”*

Në poemën *Iliada* Homeri përdor fjalën Lubia ose Himera. E rritur nga mbreti i Karisë, Amisadori, ajo u kallte lemerinë banorëve të vendeve përreth, duke vjellur flakë e duke shqyer cilindo i cili kishte fatkeqësinë të dukej në rrugën e saj. I frikësuar se përbindëshi mund të sulmonte edhe detarët e tij, mbreti i Likisë iu lut Belerofontit që ta çlironte nga një fatkeqësi e tillë. Ky i fundit, hipur në kalin Pegas e shpoi Himerën me shigjeta dhe e vrau përbindëshin në malin Krag (ndoshta Himera ishte personifikim i malit që nxjerr zjarr se Krag do të thotë vullkan i shuar). Homeri te *Iliada* shprehet: *“Kur doli agimi gishtatrëndafilti/ Të dhjetën ditë, atëherë e pyeti plaku/ E i lypi shenjën që për të kish’ çuar/ dhëndëri i tij Preti./ E kur të zezat shenja të dhëndërit mori,/ Në krye i dha urdhër të vrasë lubinë,/Që asnjëri s’e mposhti./ Me gjak e fis hyjnish kuçedra ishte/ Në kokë luan, dhi në mes, në bisht dragua/ E zjarr shkumbues për tmerr nga goja villte/ Ai, i mbështetur në fuqinë e zotave,/ Lubinë e vrau, pastaj kundër/ që u ndanë kudo me nder luftoi/ dhe i mundi./ Kjo që për të lufta më e rreptë që bëri”* (Homeri, *Iliada*, Kënga VI, v.214, 1979: 104).

Nga Hesiodi, mësojmë se njëra nga tri kokat e Himerës, ishte kokë gjarpri. Ky autor tek

Kozmogonia (shekulli 8 – të p. e. s.) shkruan: “Himera që fryn zjarr, një krijesë e frikshme, e madhe, e shpejtë nga këmbët dhe e fortë, që ka tre kokë - një luan gri - eyed, një tjetër të dhisë dhe një tjetër të një gjarpri. Nga përpara është luan, nga pas dragua, në mes dhi dhe fryn fuqishëm zjarr të tmerrshëm” (Hesiodi, *Kozmogonia*, 319).

Siç shihet Homeri dhe Hesiodi këtë përbindësh e përshkruajnë si femër. Kjo, sipas mendimit tim, ka lidhje me emrin e saj që nga greqishtja mund të përkthehet si “dhi-femër” (greq. Χίμαιραν).

Një autor tjetër i rëndësishëm i antikitetit që e përmend Himerën, është edhe Virgjili (70 p. l. K.) me veprën e tij *Eneida*. Ai e rendit Himerën mes përbindëshave të tjerë që i sheh Eneu përgjatë udhëtimit të tij në ferr: “dhe shumë përbindëshat të tjerë/ aty kanë strofkën/ përsipër dyersh: Kentaurë, Skila dy trajtash,/ Briareu me njëqind krahë/ dhe Hidra e Lernës,/ që fërshëllen në një mënyrë të tmerrshme/ edhe Kimera e armatosur me flakë,/ Gorgonat dhe harpitë dhe ai përbindëshi,/ sajuar me tre trupa” (Virgjili, 1996: 210). Edhe Platoni, Tit Lukreci, Lukreci, Pseudo Appollodori, Anaksilasi e përmendin mitin e Himerës në punimet e tyre.

3. Vjetërsia e mitit të Himerës

Si interpretohet Himera? Kjo është një pyetje e natyrshme, meqë qenia në fjalë nuk është e natyrshme.

Që në fillim pati një interes të madh për këtë kur u zbulua një mbishkrim në këmbën e parë të statujës. Shkrimi nuk qe i qartë dhe interpretimet për të lulëzuan – Timmsifil, Taninhesel, Tiumquil dhe të tjerë. Disa propozuan që këto qenë emrat e autorit, të tjerë propozuan emra si “dhi” apo “hakmarrje”. Sot ka një pajtim me interpretimin e propozuar nga L. A. Milani më 1912 se mbishkrimi tek statuja duhet të lexohet *Tinscvil* apo *Tin’svil* që do të thotë “ofruar zotit Tin” në gjuhën etruske. *Tin* apo *Tinia* është zoti suprem i fiseve etruske, apo Zeusi i grekëve dhe Jupiteri i romakëve (Jorgji, 2011: 7).

Sipas kësaj hipoteze, Himera është ofrimi i bërë ndaj perëndisë supreme. Sot ne dimë se ofrimi i statujave ishte zakon tek këto fise dhe ata i

vendosnin këto statuja prej bronxi në tempujt e tyre. Historia dëshmon se mbi 2000 statuja qenë në *Fanum Voltumnae*, tempulli më i madh etrusk, i plaçkitur dhe i shkatërruar nga romakët.

E megjithë këtë, është e vështirë të shpjegohet se ç’kuptim kishte kjo statujë për etruskët. Gjëja e parë që të bie në mend është se do të jetë vështirë të pranohet ky arsyetim se një përbindësh tresh paraqet perëndinë supreme. Ndaj është vështirë të bëhet interpretimi, ndonëse ka një sërë hipotezash, që vështirësohen akoma më shumë nga moskuptimi i psikologjisë së më shumë se 2000 vjetëve më parë.

Natyrisht ka edhe interpretime “racionale” që kanë filluar prej shekullit IV të erës sonë, sikurse ka bërë Servius Honoratus, i cili mendonte se Himera është produkt i etruskëve naivë për të paraqitur vullkanin si një kafshë që “villte” zjarr.

Një nga statujat më të rëndësishme me figurën e Himerës, është ajo e Arecos. Është një statujë bronzi e gjetur në qytetin italian të Arecos (it. Arezzo). Historia e këtij objekti nis e shfletohet në arkivat e këtij qyteti. Duke nisur nga faqja 102 e këtyre arkivave, thuhet se më 15 nëntor 1553, ndërsa po gërmohej jashtë mureve të qytetit, u gjet kjo statujë së bashku me statuja të tjera të vogla. Raporti cilëson: “*nempe hoc qui viderunt amne admirati sunt et operis antiquitatem et elegantiam*” (“sa të gjithëve u kishte bërë përshtypje vjetërsia dhe eleganca”).

Për këtë moment, Benvenuto Cellini te libri i tij *Vita (Jeta)*, e botuar më 1558) shkruan: “*Këto ditë u gjetën disa gjëra të vjetra në kontenë e Arecos. Ndërmjet tyre ishte një Chimaera, që është ai luan bronzi që shihet në dhomat afër sallës së madhe të pallatit*”³⁷.

Këtë statujë të Himerës, ekspertët e cilësojnë si me origjinë etruske dhe e datojnë rreth shekullit V p. e. s.. Ajo është ekspozuar në Muzeun Arkeologjik Kombëtar të Firencës. Por artistikisht është një nga shembujt më të mrekullueshëm që ekzistojnë në botën e artit të lashtë etrusk.

³⁷ Së bashku me të lartpërmendurën Himerë u gjetën edhe një numër i madh statujash të vogla, që ishin të tëra të mbuluara me dhe, apo me ndryshk dhe secilës prej tyre u mungonte ose dora, apo këmba. Duka qe tepër i kënaqur kur i pastroi vetë ato, duke përdorur vegla argjendari.

Për përjetësimin të kësaj figure mitologjike, shkruan Nermin Falaski Vlora. Ajo thotë: “Në muzeun arkeologjik të Firencës, veç të tjerash është ekspozuar një kompozim monstri, një luan i ngërdheshur para sulmit. Bishti i tij është një gjarpër që në shtrirje kap nga brirët një dhi. Përbindëshi quhet në gjuhën e lashtë “Himera”. Në muze shpjegimet jepen në gjuhën etruske, fjalët e të cilave shpjegohen vetëm me anë të gjuhës shqipe (Agim Shehu, *Himara – një vështrim në dokumentat historike*, gazeta “Kombi” shtator 1992.).

Interesi për Himerën duket edhe në riprodhimet e statujës së mësipërme të cilat u vendosën në stacionin e trenit të Arcos. (Shih fotot më poshtë).

4. Shpjegimi i Himerës

Shpjegimi i parë modern mbi Himerën është dhënë nga italianii F. Inghirami tek “*Monumenti Etruschi o di Etruschi Nome*” (vol. 2, f. 379-384, botuar në vitin 1824). Duhet thënë se Inghirami nuk ishte në dijeni të plotë të mitologjisë sumeriano/ babilonase dhe shpjegimi i tij është pak a shumë skematik. Shpjegimi bazohet në Seviusin, e cila e nxjerr këtë mbi historinë Liciane sipas së cilës ekzistonte një vullkan, që besonte se qe Himera, ku “në majë të malit ndodheshin luanët, në mes të këtij mali kishte dhi dhe kudo kishte të përhapur gjarpërinj.” (Inghirami, vol. 2, 1824: 379-384).

Bullfinch, në veprën e tij monumentale *Koha e Fabulave apo historitë e Perëndive dhe heronjve*, padyshim citon Himerën, duke e klasifikuar si monstër. Monstrat klasifikohen si qenie me përpjestime jonatyrale të trupit. Zakonisht të shikuar me tmerr, meqë kishin fuqi të mbinatyrshe dhe mizore, të cilat mund të dëmtonin apo edhe të bezdisnin njerëzit.

Kjo qenie ishte vendosur në Licia, ku mbreti i këtij vendi Jobati, po kërkonte një hero që të mund ta çlironte vendin prej saj. “Ndodhi që në oborrin e tij, arriti një luftëtar i ri i quajtur Belerofonti. Ai i paraqiti letrat nga Proetusi, dhëndri i Jobatit, me anë të të cilave e rekomandonte atë si një luftëtar të pamposhtur. Këtu fillon edhe intriga pasi letra përveç rekomandimit pozitiv,

përmbante edhe kërkesën që vjehri ta vriste heroin. Arsyeya ishte se Proetusi dyshonte shumë se gruaja e tij Antea e shihte me shumë “dashmirësi heroin”³⁸.

lobati ishte në pozitë të vështirë. I duhej njëherësh të kënaqte si kërkesën e dhëndrit, po ashtu të tregonte edhe mikpritjen e nevojshme. lobati mendoi gjatë dhe i ra ndër mend t'i zgjidhte të dy këto njëherësh – duke e çuar Belerofonti të luftonte me Himerën, sfidë e pranuar nga heroi.” (Bullfinch, 1852: 62).

Përveç autorëve të mësipërm, Nathaniel Hawthorne në të njëjtin vit me *Mitologjinë* Bullfinch-it e shkroi për Himerën dhe Belerofonti në librin e tij *A wonder-book for girls and boys (Libër përrallash për djemtë dhe vajzat*, 1852). Hawthorne i mëshon idesë (gjithmonë nuk duhet harruar se është një libër për fëmijë) se “Himera ka krahë” (Hawthorne, 1852: 83), ide që ka munduar për shumë shekuj interpretuesit e mitit. Arthur Charles Fox-Davies botoi më 1925 *Complete Guide to Heraldry (Guidë e plotë e emblemave)*, në të cilin miti i Himerës citohet si Chimera. Ai e përshkruan si “kafshë që ka kokën dhe gjoksin e një femre, panxhat e një luani, trupin e një dhie, këmbët e pasme të një grifini, bishtin e një dragoi dhe është aq e shëmtuar sa nuk bëhet” (Fox-Davies, 1925: 75).

Robert Graves shkroi në 1960 *The Greek Myths (Mitet greke, ribotim i punuar)*. Ai bën përpjekjen e parë në shekullin e shkruar për të bërë një shpjegim të Himerës duke iu përmbytur linjave të mitologjisë së lashtë. Për këtë autor, “Himera, kjo qenie mitologjike është simboli i Treshes së Perëndeshës së Madhe të Vitit të Shenjtë-luan në pranverë, dhie në verë dhe gjarpër në dimër” (Graves, 1960: 152). Pas një viti Graves i referohet sërish Himerës në librin e tij *The white Goddess (Perëndesha e Bardhë)*, ku përshkruhet historia e Belleferonit që shkon të vrasë Himerën (Graves, 1961: 64). Këtu Pegasi citohet si Aganippe, e rrjedhur nga mbiemri me të cilën Homeri quan heshtën e Artemisit dhe të Apollos, term i cili do të thotë “që sjell një vdekje të

³⁸ Këtu fillon edhe përdorimi i shprehjes “letra Bellefonike”, me të cilën kuptohet çdo lloj komunikimi mbartur nga një person pa paragjykuar fare veten.

ëmbël”. Kështu Pegasi “ripagëzohet” si “mushka që sjell vdekje të ëmbël”.

Më 1977 antropologu italian Alessandro Ferrari në librin e tij *Carta canta (Letra folëse)* sjell një hipotezë interesante për mitin e Himerës kur shtron pyetjen: “A mund të ketë mbijetuar miti gojor i Himerës që nga kohët e Etruskëve?” (Ferrari, 1977: 92). Ai përshkruan historinë e Luiginos me përbindëshin që jeton në Toskani dhe që i ngjan shumë historisë Sumeriane të Innanës dhe të zogut Anzu.

Fizikanti dhe studiuesi i mitologjië Stephen Wilk, në librin e tij *Medusa, solving the mystery of the Gorgons (Meduza, zgjidhja e misterit të Gorgoneve)*, përpiket të bëjë një interpretim astronomist të disa miteve të tillë si: Perseut, Medeas, Andromedas. Kështu, duke cituar mitin, thekson: “Belleferoni e vret Himerën duke e gjuajtur me shigjeta dhe së fundi duke i hedhur një top plumbi që e vrau përbindëshin. Stephen Wilk beson se shigjetat janë meteroidet e Perseut, me të cilët lidhet edhe emri i Belerofonti që mund të shpjegohet me termin “lëshues shigjetash” se sa vrasës i Bellerus-it . Po ashtu ai beson se masa e plumbit është ylli Mira, i cili një herë në vit kthehet i kuq në barkun e përbindëshit (Wilk: Jorgji, 2011: 5).

Borges, nobelisti i famshëm, në librin e tij *El aleph* (shkruar më 1946), përshkruan pa e përmendur Himerën në tregimin e tij “*El immortal*”. Po kështu ai e rimerr mitin në librin *The book of imaginary beings (Libri i qenieve imagjinare)*, botimi anglisht më 1969, përkthyer në shqip në qershor 2006). Borges citon të përmendurit e Himerës nga Homeri, në këngën e gjashtë dhe Virgjili tek *Eneida* (përsëri tek kënga e gjashtë), si dhe sjell në kujtesë mbiemrin “himerik”. Ai sjell edhe një shpjegim tjetër kur thotë se Himera qe një pirat, i cili e kishte zbukuruar anijen e tij me figurat e luanit, dhisë dhe të një gjarpri. Borges thotë se fjalorët dhe diksionarët japin përshkrime të kota të Himerës që nuk duhen besuar (Borghes, 1969: 32).

Shpjegime për mitin e Himerës jepen edhe sipas Guus Houtzager tek *Mitologjia Greke*. Himera, për të ishte një përbindësh që kishte tri kafshë në trupin e saj. Kishte kokë luani, pas në mesin e

shtyllës kurrizore një kokë dhie dhe në fund bishtin me kokë gjarpri (Houtzager, 2004: 80). Një shpjegim të ngjashëm kanë dhënë edhe: Po kështu, Gary Gygax me *Monster Manual for D&D (Manuali i Monstrave për Didin)*, botuar më 1978), John Barth me *Chimera* (botuar më 1972), Evan Morris me *The word detective* (botuar më 1996), Bernard Evslin me *The Chimaera* (botuar më 1988) kanë bërë shpjegime për Himerën; por Himera do të bëhet edhe simbol për kirurgjinë e transplantëve të Shoqatës Amerikane të Kirurgëve të Transplantimeve. Sipas Barry Kahan (në shkrimin e gushtit 1989, në periodikun amerikan), logoja e Shoqatës është një “simbol që jo vetëm trupëzon thelbin, por edhe shpirtin (spirit) e specialitetit”.

5. Simbolika e Himerës kaone

Në mitologjinë shqiptare, e vjetër sa dhe vetë shqiptarët në këto troje e hapësira, ekziston një përbindësh i tillë me shumë kokë, me trup gjarpri që nxjerr zjarr nga goja. Është po ajo kafshë mitologjike, që nga pellazgët e etruskët quhet Himera. Sipas R. H. D’Angely, etruskët, tirrenasit ose tirrenianët dhe lelegët, janë po ai popull i racës pellazge që flitnin të njëjtën gjuhë, pellazgishten, me disa dallime të vogla dialektore, të cilat i shpjegon vetëm gjuha shqipe (D’Angely, 1990: 32).

Një kompozim mostri, me kokë luani ngërdheshur para sulmit me bishtin e tij të një gjarpri që në shtrirje kap nga brirët një dhi, përmend dhe Sami Frashëri në *Fjalorin enciklopedik turk* (Agim Shehu, *Himara – një vështrim në dokumentat historike*, gazeta “*Kombi*” shtator 1992). Ndonëse në thelb është një dhi, përshtypja e parë që krijohet kur e sheh Himerën, është ajo e një luani, për shkak të kokës së luanit, e cila është vendosur mbi trupin e dhisë me bisht në formë gjarpri. Ndërkaq ka një armë të fuqishme - nga goja lëshon flakë të tmerrshme. Tërë pamja e saj, të duket tepër jo-logjike (si i ati i saj, Taifoni) sikundër për syrin, ashtu edhe për mendjen.

Edhe Marin Barleti te *Historia e Skënderbeut* i referohet Himerës, por disi më ndryshe dhe gjithmonë kafshë mitologjike.

Himera, në mitologjinë e Bregdetit, është një kafshë e përbindshme që shfaqet kur dikton viktimën e pastaj zhduket. Mendohet se jeton në malet Akrokeraune ose të Vetëtimave. Himera është kafshë e steresë që “viktimat e saj” i godet me “flakët e gjata” që i ngjajnë një gjarpri të zjarrtë.

Po si i mbeti ky emër përbindëshit që jeton vetëm në imagjinatën e njeriut të lashtë, këtij vendbanimi apo treve të Bregdetit të Jonit? Siç e përmendëm më lart, prej malit të Akrokerauneve, lëshohen pandërprerë vetëtimat dhe stuhi. Perëndizimi i dukurive të natyrës prej njerëzve të lashtë, tashmë dihet.

Na shfaqet trinomi ZEUS KAON –MALET E VETËTIMAVE (ku ai banon) – HIMERA (perëndia e shtrëngatës që e dërgonte Zeusi i zemëruar për të ndëshkuar njerëzit e pabindur dhe ata që kishin kërcënuar sundimin e tij dhe që ka fizionominë e asaj kafshës së përbindshme që evidentuam më lart).

Me Himerën lidhet një ndër dukuritë specifike meteorologjike e më mbresëlënëse të Krahinës së Bregdetit që quhet Sifoni, ose Stihi. Ai, në kuptimin popullor, është i shtrirë nga retë mbi malet Akrokeraune e deri në det. Zbriste po nga reja lart e futej në det. Thithte ujë prej tij, përpinte anijet, shkulte ullinjë. Populli mendon se kaq fuqi ka sifoni, sa nxjerr ullirin nga toka në Palasë dhe e shpie në Vuno. Po ta prisnin, nuk bënte dëm, ndaj bënin çdo lutje e kryenin disa rite për ta “prerë”. Dhe të gjitha e kishin burimin te Himera.

Edhe karakteristikat gjeografike të trevës rreth vendbanimit të Himarës japin pamjen e një përbindëshi. Malet Keraune (Akrokeraune), përmbledhin vargun malor që ka për kulm të tij Majën e Çikës, me daljen e zgjatuar në brendësi të detit. Për këtë arsye, këtë dalje në brendësi të detit, banorët e të dy anëve e quajtën “Gjuhë”. Ndryshe quhet “Kepi i Gjuhëzës”. Kjo dalje i ngjan një gjuhe të gjatë të një përbindëshi që s’është gjë tjetër veç Himeras, sipas banorëve. Njëra anë e “grykës” apo e “gojës” së “përbindëshit”, është përroi i Ksilorahit në veri të Palasës. Ai zbret nga rrëza e kulmit të Çikës dhe ka lidhje të drejtpërdrejta me shpatoret e majës, nën të cilat

kalonin rrugët e lashtësisë. Pikërisht, ky përroi me relievin që ka, përputhet me përshkrimet e Homerit. Kurse ana tjetër është matanë Llogorasë, në rrëzën e malit të Qorres, ku nis përroi i Dukatit. Gjuha është pjesë e gojës dhe goja pjesë e kokës. Kur hapet goja, zgjatet gjuha gjigande e mbuluar me zjarre që shoqërohen me gjëmime të tmerrshme.

Pra, për vetë karakteristikat gjeografike me pamjen e një përbindëshi, dukurive specifike meteorologjike të kësaj zone dhe pamundësisë, në lashtësi, për t’u dhënë shpjegim, imagjinohet një përbindësh i fantazuar në distancë, i cili kohë më kohë nxirrte zjarr nga goja, që shoqërohej me gjënimet e shtrëngatat. Kush pati kurajon të afrohej, u gjend jo para një përbindëshi, por para malesh që pritëshin prej shpatësh të zjarrta. Përplasja e tyre në tokë lëshonte një zhurmë që trondiste dheun. Pas tyre niste një shtrëngatë e papërmbajtur me rrebesh ujërash të rrëmbyeshëm, sikur donte që “të ndëshkuarit” t’i merrte me vete e t’i çonte në det. Dhe mali e vendi pastrohej nga të pabindurit, që kishin shkaktuar zemërimin e **Hiut që të Merr**.

Mos vallë qyteti i Himerës pellazgjike ka qenë këtu ku ndodhen këto dukuri, ku ndodhet gjuha dhe gryka e “përbindëshit”?

Po të përshtatim pjesën e parë të fjalës Himera me gjuhën e sotme, themi se **HI-U** do të thotë Perëndi (Hyu, por që në Bregdet thuhet HI, sepse në të folmen e Bregdetit, fonema Y që nuk përdoret fare, është zëvendësuar me I). **Mera** do të thotë që të merr, të vret me shigjetat e zjarrit dhe goditjet qiellore. Himera, a Imera ishte perëndia e shtrëngatës që si e përmendëm e dërgonte Zeusi i zemëruar për të ndëshkuar njerëzit e pabindur dhe ata që i kishin kërcënuar sundimin. Pra në mënyrë riciklike Himera krijonte Sifonin ose Stihinë.

Mirëpo, këtu na del përpara edhe një shpjegim tjetër: Himera ka mundësi që të lidhet dhe me fjalën e sotme **Hi – ri** (mbetja pas djegies së plotë të drurit ose të çdo trupi të ngurtë e të djegshëm), të jetë evoluim semantik i shkakut, i burimit tek pasojat, madje pa pësuar asnjë ndryshim fonetik veç kuptimor. Hiri është mbetja materiale e ndëshkimit, pasojë e fajit, por edhe

simbol i shkatërrimit dhe i rilindjes nga hiri, riinkarnimi. Kjo tendencë e rilindjes nga **Hi – ri**, sipas mendimit tim është e lidhur me Feniksin duke u nisur dhe nga fakti që shpreh Homeri se përroi i Himerës zbrit nga Akrokeraunet dhe quhet “Feniks”. Mbi këtë logjikë, dalim në përfundimin se pjesa e parë **Hi** e fjalës Himera është parësore që përmban kuptimin themelor burimor të fjalëve. Kurse pjesa e dytë është veprimi (mer), cilësia, epiteti i përmbajtjes, ligësia (dreq).

Historianët e lashtësisë, ashtu si dhe gojëdhënat, bëjnë fjalë dhe për disa hollësi të vendit të objekteve përreth qytetit të lashtë. Veç asaj që përmend Homeri se përroi i Himerës zbrit nga Çika dhe quhet “Feniks”, tregohet edhe se nga këto male ciklopët qëlluan me gurë Odisenë. Është vendi, i cili sipas studiuesve, përmendet nga Circea në udhëzimet e saj drejtuar Uliksit (Homeri, *Iliada*; Pukëvili, 1999: 66). Sipas Homerit, Odisea u nis nga ishulli Ajaja, ku banonte hyjnesha Circe dhe, sipas porosive të saj, lundroi nga Perëndimi drejt Lindjes dhe arriti “aty ku është krahina dhe qyteti i burrave himariotë” (Homeri, 1860: 166). Pukëvili në shënimet e tij shkruan: “Himara më e re nuk i ka ruajtur gjurmët e lashtësisë. Por po të shohësh me kujdes, mund të dallosh mbeturinat e një mjedisi pellazgjik që ka mundësi të jenë të Himarës homerike, të cilën Plini e vendosi në Akrokeraune afër Burimit Mbretëror. Ky fortifikim i vjetër quhej nga vendësit “kështjella e vjetër e mbretëreshës”. Këtë emërtim e ka marrë për shkak të monedhave që gjejnë shpesh aty me fytyrën e një femre në njërën anë dhe Pegasus në anën tjetër, emblema që zakonisht i janë atribuar Apollonit” (Pukëvili, 1998: 147).

PËRFUNDIM

Pra si **përfundim**, i njohur që te etruskët dhe grekët, miti i Himerës te kaonët merr një rëndësi të veçantë sepse është i lidhur me toponiminë e një prej vendbanimeve më të rëndësishme të Kaonisë, Kimerën (Himerën), (Himarën). Në rrëfimet për këtë emër vendi, paraqiten subjekte në brendësi të së cilit vërehen dukuri mitike të një kohe të lashtë. Zbërthimi i simbolikës së

Kimerës si toponimi, në thelbin e tij si origjinë, është me interes në sqarimin e shtresave më të hershme kulturore të mitit në formën e tij më të lashtë.

BIBLIOGRAFIA

- BIXHILI, Foto (2004), *Jipet e Iperit – himariotët*, Tiranë.
- BUDINA, Dhimitër (1977 – 1978), Mozaiku i trikonkës paleokristiane të Antigonesë”: *Iliria 7-8*, Tiranë.
- ÇABEJ, Eqrem (1976), *Zakone dhe doke të shqiptarëve: Studime shqiptare vëllimi V*, Rilindja, Prishtinë.
- D’ANGELY, R. H. (1990), *Enigma e pellazgëve*, Toena, Tiranë.
- DESHARME, F. (1959), *Mithologjia tis arkeas Ellaios*, Athinë.
- DOMMERNUTH-GUDRICH, Gerold (2006), *Mitet*, Tiranë.
- GRAVES, Robert (1960), *The Greek Myths*,.
- GRAVES, Robert (1961), *The white Goddess (Perëndesha e Bardhë)*.
- HOMERI (1979), *Iliada*, Tiranë.
- HOMERI (2006), *Odisea*. Përkthimi në shqip P. Gjeçit. Onufri, Tiranë.
- HOUTZAGER, Guus (2004), *Ελληνική Μυθολογία*, Athinë.
- ISLAMI, Selim (1965), *Iliria dhe ilirët tek autorët antikë*, Tiranë.
- JORGJI, Kristaq *Skulptura e Himerës*, 2011.
- KORKUTI, Myzafer (1982), “Sudost Evropa Zëischen 1600 und 100 V.Chr.”, Berlin.
- OVIDI (1992), *Metamorfozat I*, Tiranë.
- PILIKA, Dhimitri (2005), *Pellazgët origjina jonë e mohuar*, Botimet enciklopedike, Tiranë.
- PUKËVIL, F. (1998), *Udhëtim në Greqi nga Brindizi në Janinë*, Tiranë.
- PUKËVIL, F. (1999), *Në oborrin e vezirit të Janinës*, Tiranë
- SHEHU, Agim (1992), *Himara – një vështrim në dokumentat historike*, gazeta “Kombi” shtator.
- VIRGJILI (1996), *Eneida*. Përkthyes Henrik Lacaj, Tiranë